

2/65

— HYSEN B. EMIR —

Xixëllime

Shpresimi

Ja si shkëlqen shpresa! Shkëndi të shpërndara formojnë shpresën...

Në thellësitat e shpirtnavet; në tingëllimet e kohës shpresa jehon!... Ndigjohet...

Erdhi vjet' i ri: Pruri shpresat e reja... Brezat janë rikrijue me radhë... Shpresa s'ka humbun... Dhe si një shkëndi e madhe duket e ardhshmja!

Ja! Si po shkëlqen!... Asht shpresa që xixëllon!..

.....

Duket një orizont i ri atje largë, ku shpresa bannon!.. Ja! Si xixëllon! Thue asht flakë... Po!!.. Largë në kohën e ardhshme një flakë shpresohet që po ndritë dhe si ka ndritun!..

Shpresa! Zani jehon.. Kanga ndihet!.. Shpresa përtrihet...

Ja po ndritë!.. Xixëllime! Flakë! Dritë!!.. Atje largë në orizont!..

Shpresa e shpresueshme!!

* *
*

Ja shpresën që kaloi në dorë!!... Dhe ta kapim!..

Muajtë iknin njani mbas tjetërit. Vjeshta erdhi dhe gjethet filluan të zverdhen, por bashkë me 'to treteshin dhe dy shpirtna, të quajtur tok 'një!... Kukurvajkat me melodinë e tyne trishtuese, ja kishin nisë këngës së tyne përvajshëm dhe dukej se dhe ato vajtonin fatin e dashnorve, dukeshin se vajtonin humbjen e dashtnisë së parë!

Kontrata e lidhun u plotësua; flutura do shkonte ke ujku...

*Ik o, shpirt e tani bjerë:
Kujtimin e Karillës së mjerë!
Mjaftë vuajte në sh'reti,
Ik tani në dhe të zi-iii...*

Këto këndonte Katina në dasmën e sajë, ndërsa në vëndin ku ishte ngritur tända apostatat, këngët kishin kalue lufin, qejfi e dëfrimi s' kish të sosun....

*Ç' asht a j djal, shtat hedhur,
Ç' asht a jo flutur, gjeraqinë,
Që të dy me flokë krehur:
Na kanë zbukuruar shtëpinë....*

Krushqët erdhën; Katinës iu hodhën telat e nusërisë dhe këngët vazhduan pa pushim... Vera dhe birra quheshin ujë!...

* *
*

Prej së largu ndigjoheshin të brituna njerzish, vajtonin një të vdekun, vajtonin Karillën.... Revolveri kishte qenë mjeti shpëtuës për 'tá; ky ju kishte dhanë fund brengave të dashtnisë së parë...

Zërat vajtuës si thikë përshkuan zëmrën e djegun dashtnorë vajtimi përgatiti një viktimë të dytë, shpirti i Katinës u bashkue me atë, që për natë e ëndërrontë... Zëmra e helmuar u bashkua me shpirtin e helmuar... Revolveri e helmi bashkuan për jetë dy shpirtna dashtnorësh, mbyllën tragjikisht dashtnin e parë!... Zakoni sundoj, dashtnija shkrettoj; shkrettoj dy filiza të rij!...

NOVELË

Kur sundon zakoni

Prilli numëronte ditët e tij të para. Bilbili ja kishte nisë këngës së tij kujtimore dhe në drurët e gjelbëruar këndonte këngën e dashtnorve të lirë!... Prilli kish prurë gjallnimin; Prilli kish bashkuar zëmrat dashtnore.

Kodra e fusha zbardhonin nga lulët shumë ngjyrëshe; dalloheshin si të mbuluara me dëborën dimnore dhe në 'to rinija lodronte gazmuëshëm; shijonte e qetë muajin e lulëzimit.

— Ah! muaj' i bukur! Oh, shijaësa të lulëzimit: Loja e juej plot' gazmend i shtonë ma tepër mjerimet e mija, e banë ma të vështirë jetën t' ime; më hapë plagë të reja!...

Këto thesh Katina; këto thoshte vajza e dashtnisë së humbur; këto thosh e burgosuna për jetë, kur shikonte shoqet e sajë tue dëfrye dhe kur nga fusha e gjerë me lule, vinte era aromatike dhe fllad' i hollë i lulëzimit.

Prindërit e kishin plotësue detyrën e tyne të përjetëshme: Katinën e kishin mbyllun, për mos me u takue ma me Karillën, me dashtnorin që zgjodhi zëmra e sajë e parë... I fejuemi i Katinës nuk ish ai, që ajo ëndërronte, nuk ish ai, që bashkë kishin shijuem voglin, muajët e ambël të prenverës, gëzimin e hidhnimin; por ish një i pa njohun për' të, ish një plakosh i bukur, një kulet madh!...

.....
 Katina sa kalonte koha, ma shumë binte poshtë: Ftyr' e sajë që dikur kish qenë pors i një mollë, ngjasonte me limonin pa lëngë; kishte mbetë si skelet dhe me psherëtime e hidhnime kalonte ditët... Mendimet e sajë ishin të hidhuna; paja e sajë ishin vjershat kujtimore dhe për bashkëshortin e sajë të përjetshëm mendonte dheun e zi.

Qytetit t' im

Shoh prej së largu male me rrobën e gjelbërimit,
 Shoh drur të mveshun me rrobën e lulëzimit;
 Kur Pranvera rrezet e sajë shëruese lëshon
 Syri tej-shikuës lulëzimin e Natyrës shijon...

Dielli shkëlqyes Pranveror kur t' argjentat rreze lëshon
 Qyteti merr ngjyrën e gjallnimit, gjallnin zgjon...
 Gjanica e ndritun prej rrezeve ndriçuese, kullueshëm
 [shkon,
 Ujt' i qetë, druajt' e fusha t' gjelbërueme, gazin shton...

Oh! asht qyteti im, pranë Apollonis së ndjerë,
 Asht qyteti im, pranë detit t' kaltërt përherë!...

Dhe kur Dimn' i furishëm me tonin e tij dërpëton,
 Kur deti kaltërt tallazet rrëmbyese i shton:
 Ah! at' her qytetin t'im, ushtima e detit e zgjon
 Dhe kneta, si liqen i bukur, shpezët n'suprin i shton!

Shoh prej së largu male e Tomorrit legjendar.
 Shoh drurët e zhveshun e nga dëbora të thar:
 Kur Dielli rrezet e vona nga Tomorri lëshon
 Syri tej-shikues dborën e bardhë shijon...

Ah! asht qyteti im, rrethuar prej drur e malesh legjendar,
 Asht qyteti im, që me panoramën madhështore, m'gë-
 [zon në t' par'..

Shokut M. E.

Të korrinat

Puna pa vegla e vegla pa punë s' vlen

H. E.

Dielli djek' e pjek' drapëri vap-vup, punon,
Djersa çurk rrjedhë, vu-vu-u, s' pushon!
Dhe gruni duej, duej lidhet, n' ara shtrohet:
Kur Dielli perëndon, me gaz puna lëshohet...

Dhe dita agon, vapa të përvloj fillon,
Toka laget me djersë, puntori punën vazhdon!
Dhe drapëri, vap vup, kangën s' pushon:
Dora e regjun, duejt radhë, radhë i shtron...

Karkalecat përpyjet hidhen, gjinkalla kangës ja thotë:
Punoni, o djersë piko! Rrjedhja jote nuk shkën kotë!
Lumnin të bije, për Dimën hambaret t' i mbush plotë!
Dhe puno, puno sa rron mbi tok, puna lumni para-thotë!..

Djelli djek' e pjek, drapëri vap-vup, punon,
Djersa çurk rrjedhë, vu-vu-u, s' pushon!
Dhe gruri duej, duej lidhet, n' ara shtrohet:
Kur Dielli perëndon, me gaz puna lëshohet...

Korrik, 1938.

Tingëllim...

N' muajin e luleve bilbili këndon
n' agim :

Nga gjumi Dimnor, ay, na zgjon
flutrim . . .

Melodia gazmuese n' frym t' re
tingëllon :

Ngreu, o i fjetun, zgjon me ne
lajmëron . . .

Me t' dalë Marsi, Prilli i luleve
na kujton :

Melodia e bilbilit, muaji pekuleve
na zgjon . . .

Kanga e lirë me erën e luleve
tingëllon :

Ngreu, o i fjetun, asht muaji pekuleve
lajmëron . . .

*
* *

N' agim... kanga e lirë e bilbilit
na kujton :

N' agim... t' ditve t' bukra t' Prillit
kujtimin zgjon...

Prill, 1939

Hije-Diell

Agoj... Kang' e bylbylit mi gjelbërimin e pemve buçet,
Agoj... Trandafili lëshoj gouxhet e tij udën fletë,
Bylbyli shijon lindjen e t' kuqit trandafil,
Trandafili vesën q' i rë, e zan' e t' lumtnit bilbil...
Erën e bukur e lshon trandafili, kanga e bylbylit buçet:
I lulevet, i shpendëvet jé, jam i pari Mbret...

* *
*

Djelli rrezet lëshoj, gjallnimi u zgjna,
Gjulluimi gjalluim zgjon, lëvizja u shtua...
Hija e drujvet jep freskinë, Dielli shkëlqen,
Kanga e bylbylit vazhdon në hije, s' vlen...
Hija freskuse nga pak po çdukej, Dielli e zinte,
Hije — Diell, ndryshimi gjithmon vinte...

* *
*

Perëndim... Bylbyli nisi kangën e dëfrimit,
Perëndim... Qielli u s' kuq, mori cipën e errësimit.
Natë... Hana rrezet e sajë t' shndritshme lëshoj,
Natë... Kupa e qiellit, yjt radhë-radhë i shtoj...

Bylbyl, trandafil, kangë — gjallni: agim,
Kangë, errësin, heshtje — vetmi: perëndim...

Mbi Migjenin...

Pse qan' bylbyl me at' za trishtuëshëm,
 Pse rri bylbyl ashtu, n' zí, vajtueshëm?...
 Mos asht shue Dielli e nuk ban dritë,
 Mos asht shue Hana, që natën shndritë?...

Mos qaj bylbyl se zëmrat na i ke trishtue,
 Mos qaj bylbyl se zëmrat na i ke hidhnue...
 Ja! Dielli rrezet shëruese po i lëshon,
 Ja! Hana ndriçuese n' qiell po xixëllon!...

Q' ke bylbyl që vajtimin s' pushon,
 Q' ke bylbyl që kangën s' vazhdon?...
 Mos zani yt' i bukur t' asht mbarue,
 Mos jeta jote e lirë, t' asht robnue...

.

Oh, bylbyl vajtimi yt tash ma shumë na ka hidhnue:
 Nji Hyll ma i shndritshëm se Dielli paska pushue...
 Merja bylbyl kangës vajtimtare, merja pa pushim,
 Merja vajit përmallshëm, të digjohet n' amëshim!...

.

Nëpër drurët e gjelbërueme, bylbyl kur ke me pushue:
 Merja kangës me të qarë, për Hyllin që asht shue...

Shtatuer, 1938.

Bylbylit skllav...

Bylbyl, kanga yte tingëllon :
Melodija yte zemrat gëzon ...

Kanga jehon,
Shpirti drithron :
Liri ...
Bylbyl, këndon
në vetmi ...

Bylbyl, kanga yte tingëllon :
Thellësisht n' zemrat na jehon ...

Kafazi të rrethon,
Shpirti drithron :
Kangë të lirë ...
Bylbyl, këndon
për hirë ...

Bylbyl, melodija yte tingëllon :
Lumni a hidhnim tregon ? ...

Këndon,
Vaj tingëllon ...
Robni!
N' kafaz këndon :
Q' ironi ! ...

Skenime

Eja, se përveç dashtnisë, s'ka gja tjetër,
Eja, se jet'e rinisë, s'matet me metër...
Shiko! Rinin si shkon, pleqin si afron,
Shiko! Koha si kalon, brezat ri-krijon...

Eja, atjè, ku koha asht lumtni.
Eja, sa jè, nesër jetën tande s'e dí...
Shiko! Dita si shkon, thue asht erë,
Shiko! Bota si rrotullon, pa prerë...

Eja, sa rron, rrojtja pa lumtni s'vlen,
Eja, s'asht von ngrija jetës perden...
Shiko! Si nxin jeta pa dashtni,
Shiko! Si ndrin jeta në n' lumtni...



Kushtue Xh. B.

Mbramja e Pranverës

Dielli kur asht tue perëndue
Orizonti duket qartë;
Dukeu male, kodrina e drurë
Të gjithë të gjelbërue,

N' fushë veroret këadojnë,
Nga mali bagtija kthehen,
N' pyll zogjt cicërojnë;
Të gjithë në punë vehen.

Edhe lumi i kulluëshëm
Hecën në qetësi,
Bariu i lumnushëm
Ja merrë me oiii!

Er' e hollë shum' e kandshme
Të mbush me gëzim;
Përnji mend njeri-u i gjor
E heqë çdo trishtim...

Dhe shijon në ëndërrime
Këtë stin' plot lumtni,
Që mban me shpres' e lëdhatime
Të ngratin njeri...

Sheq' i Vogël, 16 Maj 1938

Kanga që ndihet

Nji kangë zije, nji frym' e shpresueshme ndihet,
Katundi ka ranë në qetësi, kanga ka tret'...
Heshtja e përmortshme shkoi, kanga përtrihet,
Kangë varfërije, prallije, n' tym t' shpresimit mbet.

.....

Dhe kanga në t' harruarit këndon,
Kang' shpresimi, kang' që kangë zgjon...
Asht kanga që përtrihet n' harrim,
Asht kangë shpresimi pa mbarim...

.....

Heshtje përmortëshme, kanga ndihet:
N' tym t' harrimit tret, n' frym' shprese përtrihet!...



Kujtime

M' kujtohet oh, koh' e lumtnis që s' e kam njohun:
At' her kur në lul' e barishta t' gjelbërueme lodroja;
Pa brengime, pa njohun jetën, lumtnin shijoja . .

M' kujtohet ajo koh' e bukur që nër fush' e n' male t' gjel-
[brueme lundrojshim
As gja s' na ndante, n' fusha e n' male të shoquem
[prej vajzash shkojshim

Ah, at' her që kujtojshim lumnin t' amëshueme:
Pa mendue lodrojshim mbi bor' e lule t' gjelbrueme;
Dimn' i pa mëshirshëm na bante zemrat t' gëzueme!

Endërroj at' kohë, shikoj vendet e kalimit t' fëminisë:
Medet! Tash n' ato vënde, nuk asht më koh' e lumtnisë...



I mërguari:

Lules së mërguar...

Shof një lule, që ka mbi në kopshtin t'em:
Asht një lule, q'e dalloj, kudo që t'jem..
Kët' lule due dhe kujtimin e sajë ruaj,
Kët' lule ruaj e nga mallimi i vendit sajë vuaj...

Asht lulja e Atdheut t'lan' n'vetmi.
Asht lulja që m'kujton, për 'të dashtni...
Asht lulja e mërgimit, për deshmi:
Të mallimit, zjarr që s'shuhet, në vetmi...

Kët' lule do t'a ruaj si syt' e mí
E kur t'shkoj, atje ku m'ka zan malli:
Lulen t'eme do t'a shkul me rraj' prej dheut
Dhe t'a çoj, në tok' të vet, në zëmër t'Atdheut...

Pastaj me lulen shok do jemi, gjithmonë:
Do tregojmë përmallimet për vendin t'onë;
Asht dëshmuese ma e mirë, se e di
Q'vuajta largë në mërgim, në vetmi...

Pazanësi !...

Kërkova lumtërin shumë her',
 Por si që, mbeti prap mister!

.
 Dhe kanga jeme s'pushoj:
 N'det, n'male e fusha udhtoj...
 Kudo pyeti, por as-njeri
 nuk tha: "ku asht lumtëri"!

.
 Janë pallatet, asht argjendi,
 Janë qejfet, janë argëtimet,
 Janë hidhnimet, asht shendi:
 Pyeta; asgja s'mësova nga udhtimet!...

.
 Dhe kanga jeme s'pushoj:
 N'det, n'male e fusha udhtoj...
 Kudo pyeti, por as-njeri
 nuk tha; "ku asht lumtëri"!

.
 Tuj kërkue lumtnin iku rinija
 Dhe kanga jeme prap filloj...
 Me vrap, me vrap erdhi pleqnija:
 Kanga më tha: t'shkuarat kujtoj!...

.
 Dhe lumtnin e gjeta, por ish n'er:
 Mister që, prap mbeti mister!...

Mall' i motrës

Ike motër largë familjes, le bab e nanë,
 U ndave nga far' e fisi, se kështu ish thanë!
 Ish thanë që të rritej dhe të shkoje:
 Largë nanës e babës t'u mergojë...

Me kangë, valle, gëzim, të përcuellën ty,
 U ndave moj motër, me lotët ndër sy...
 Dhë kanga që këndohej, s'ish gëzim:
 Ish kangë dhëmshurije, mallgjim...
 Por lotët ndaleshin me pahirë, se ish thanë;
 Të ndahesh nga familja, të lësh bab e nanë!...

Shkuan ditët, ikën muajt një nga një,
 Shkuan lotët, shkoj hidhnimi; malli zë...
 Asht malli që nuk shuhet kursesi,
 Asht malli, që ndjen' një dhëmshuri....

Dhe u ndave motër, le një kujtim,
 Le kujtimin që nuk tretë n'harrim....
 Le kujtimin që nuk vdesë, por që ngjall,
 Një të madhe dhëmshuri dhe një mall...

.
 Dhe dhëmja përtypet me pahirë, se asht thanë:
 Të ikësh largë shtëpisë, të lësh bab e nanë!...

Fier, 9 Tetor 1939

FLAMURIT

Varret e dëshmorve, sot, të gjith' po dridhen,
Kohërat e tmershme, ato, kujtojnë,
Kockat e tyne, përmallshëm po hidhen,
Armët gjigante ende gjak kullojnë!

.....
Ngritjen tënde, o Flamur kujtojnë,
Shpirtnat e tyne, mallngjyeshëm për ty, jehojnë.

.....
.....
Flamur! Për ty, Arbnori rron' e për ty vdesë,
Për ty, trimnishtë asht përpjekë e fll' asht ba;
Nën hijen tënde, Shqiptari i lirë do mbesë,
Shejen ma t'shejtë, ay, ty t'ka pas' e t'ka.

.....
Prijna pra, — Flamur, nën hijen tënde fisnike
Të gjith' të bashkuar, në Zhgabën kreshnike;
Pa dallim feje e kllase, për jetë në qetësi:
Flamur, bijve tú, përmëndi fjalën liri!
Dhe n' fush' e n' male, n' prozhm' e kroje, me uji gjallni:
Gazmueshëm të ndihet, kang' e 28 Nëntorit: Liri!

Fier, 28 Nanduer 1938.

Trandafilit...

N' gjethe t' ueja, o Trandafil vesa ka rà,
 Bylbyli n' agim erën t' ande shijon
 dhe këndon...

Dielli të përshëndeti, vesën ka thà,
 Bylbyli n' Diell bukurin t' ande s' shikon
 dhe s' këndon...

Shkoi bylbyli n' dega t' hijeshueme
 pranë lumit këndon:
 lumnin e gjeti n' ferra t' gjelbërueme...

Them, o Trandafil se asht komedi
 dhe jeta jon':
 Ngjason me atë dhe i ngrati njeri...

Bylbylin rrezja e Diellit s' e lá të qetë,
 fuqi e madhe e shlumnoj...
 Ferrën quajti lumni bylbyl' i shkretë
 dhe atje këndoj...

*
 * *

Ferrën që e shpon' e quajti lumni,
 Se Dielli thau vesën që kish Trandafili...

BIBLIOT
TIRAN

HYSEN B. EMIRI

1/27

1-10

XIXËLLIME



SHTYPSHKRONJA • V LORA • — VLORE
1939

Të drejtën e ribotimit e ruan autori.

HYSEN B. EMIRI

X I X È L L I M E



Shtypshkronja «Vlora» - Vlorë
1939

Mësuesit t' im

..... B...

mësimet e të cilit po m' kujtohen...

H. E.

Marrë nga :

Bagëti e Bujqësija

O malet e Shqipërisë! e ju lisat e gjatë!
Fushat' e gjera me lule! q'u kam ndër mënt dit' e natë.

.

Ti Shqipëri më ep nderë, më ep emrin Shqiptar,
Zëmërnë ti m'a gatove, plot me dëshirë e me zjar.
Shqipëri! o mëma ime, ndonëse jam i mërguar,
Dashurinë t'ënde kurrë, zëmëra s'e ka harruar.

.

O malet e Shqipërisë, që mbani kryet përpyetë,
Tëmer e frikë përhapni! përpinini qiejt' e retë!

.

NAIM FRASHERI

Kur loti pikon...



Melodija e lotit

Era frynte
o, skaj më skaj
dhe i shtynte
o, lot't e saj...

.....
Ikën lotët, o medet,
si uj' o, në det
dhe lot, lot' i trishtimit
iku, o iku n' det t'harrimit!

.....
.....
Era filloj
o n' fush' e n' mal,
lotin shteroj o valë, val'!

.....
Erdhi loti, o i ri:
Pikë, pikë, o për bukuri,
dhe lot' i ri s' ka trishtim;
Gëzim, gëzim, o gëzim!

.....
.....
Loti pikon,
Kujtim zgjon:

.....
Trishtim.
Galldim!...

Nanduer 1938